



**“PRISHJA ËSHTË
NDJEKJA E EPSHEVE
PA UDHËZIMIN E ZOTIT”**



**LE TA DINË
NJERËZIT E FESË!**



**VIZITË XHAMISË “FATIH”
NË BRENDI TË KALASË
ROZAFA NË SHKODËR**

Viti 16 - Nr. 8 (186),
Gusht, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

Bajrami në shesh një traditë e bukur fetare

Në këtë ditë të bekuar, organizohet një program i pasur me ligjërata të larmishme, ku besimtarët e shumtë të pranishëm, pasi falin së bashku namazin e sabahut, kanë mundësi të dëgjojnë ligjëratat dhe këshillat e imamëve dhe teologëve të Shkodrës.





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Thotë All-llahu i Madhëruar në suren El-Kasas, ajeti 50: “E nëse ata nuk të përgjigjen ty, atëherë dije se ata ndjekin vetëm dëshirat e veta, e kush është më i humbur se ai që duke mos pasur udhëzim prej All-llahut, ndjek epshin e vet? S’ka dyshim se All-llahu nuk udhëzon popullin zullumqar.”

Ky ajet kur’anor është thelbi i kuptimit të prishjes dhe degjenerimit që po përhapet në masë në shoqëritë tona!

“Prishja është ndjekja e epsheve pa udhëzimin e Zotit”¹

Prishje është kur njeriu del nga natyra në të cilën e ka krijuar Zoti. Fjala bie: U kthyer para ca ditësh nga Medina e Resulull-llahut (a.s.) dhe mbërritëm në Rinas. Sapo hymë në aeroportin e vendit tonë, fasada e parë me të cilën përballët njeriu është një afishe e stërmadhe, me dy femra të zhveshura që reklamojnë veshje intime.

Edhe në hyrje të Shkodrës, gjatë Ramazanit që kaloi dhe deri para pak ditësh, një firmë veshjesh intime, kishte vendosur afishen e saj të stërmadhe në ballë të urës së Bahçallekut; dy femra të

1. Tefsirun-Nabulsi, vëll. 7, f. 144.

“PRISHJA ËSHTË NDJEKJA E EPSHEVE PA UDHËZIMIN E ZOTIT”

reja me veshje intime!? A ka më prishje se kaq? A ka më degjenerim se kaq? Ku janë institucionet dhe autoritetet, që kanë për detyrë të ruajnë disa norma, që po u prishën, u prish krejt shoqëria? Ku është turpi dhe marrja!?

Shihni, andej-këndej reklamohen me të madhe pije alkoolike, kazino, baste, duhani, zhveshja, lakuriqësia, si një makineri që vetëm se përhap zhveshjen nga ndjenja e turpër dhe nxit shpërbërjen e vlerave të individit, familjes dhe shoqërisë!

Thirrja islame është të ruajmë këtë begati që na ka dhënë Zoti: Familjen! Të mos e humbë Baba rolin e tij si prijës dhe drejtues i urtë në familje! Të mos lejojë Nëna që të shpërfytyrohet roli dhe pozita e saj, të mos bëhet reklamuese e së keqes për bijat dhe bijtë e saj! Mos të devijojë nga pozita e njeriut më të shtrenjtë në jetë! Të mos lejojë të na i vjedhin djemtë e vajzat, për të na i kthyer në manekinë dhe kavië për eksperimente, që kanë rezultuar fatale dhe shkatërrimtare në perëndim, para se të vinin tek ne.

Prita para ca muajsh një grup studentësh nga një vend perëndimor. Habiteshin se si funksionon familja shqiptare, që në fakt është familje e bazuar mbi një bosht të shëndoshë fetar. Më thanë me habi: Ne jemi ndarë nga prindërit tanë që në moshën 15 a 18 vjeçare! I telefonojmë nganjëherë për festa. Jetojmë secili në punë të vet. Kemi lidhjet tona, bashkëjetojmë, por pa angazhime të mëdha. Lindshmëria është e vogël, ndërsa mbajtja e kafshëve shtëpiake është e madhe dhe shenjë

civilizimi!?

Nga këtu na lind e drejta të pyesim se ku po shkon njeriu i kësaj kohe? Ka vende, ku lindshmëria është shumë e ulët. Edhe tek ne ka filluar të përhapet kjo modë e keqe, që e shkatërron jetën dhe nuk e trashëgon atë!

Prishje është shkatërrimi i ambientit dhe mjedisit, shkatërrimi i jetës ujore dhe asaj bimore. Që kur hynë OMG, organizmat e modifikuara gjenetikisht, humbëm shijen në ushqim! Që kur u hapën bazenat e rritjes së peshkut me kimikate e ushqim artificial që vjen nga kushedi se ku, i plastifikuar, humbëm shijen e peshkut; ne që na ka begatuar All-llahu me lumenj, liqen e det!? Humbëm shijen e mishit, nga bombardimet e kafshëve të gjora me hormone! Humbëm shijen e ujit! A nuk është kjo një prishje dhe shkatërrim i frikshëm, për të cilin na është tërhequr vëmendja këtu e 15 shekuj më parë!?

PRISHJA ËSHTË NDJEKJA E EPSHEVE PA UDHËZIMIN E ZOTIT

Në suren Er-Rrum, ajeti 41, urdhëron: “Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen (nga të këqijat).”

Ndërsa Resulull-llahu (a.s.) na udhëzon drejt zgjidhjes dhe sekretit të mbarësisë, kur thoshte: “Si do të veproni atë ditë kur do të devijojnë të rinjtë tuaj dhe do të shturen gratë tuaja?” I thanë: A do të ndodhë kjo, o i Dërguar i All-llahut? Tha: “Edhe më

“PËR SHKAK TË VEPRAVE (TË KËQIJA) TË NJERËZVE, JANË SHFAQUR NË TOKË E NË DET TË ZEZA (BELA, SKAMJE, KATASTROFA, HUMBJE E BEREQETIT ETJ.), E PËR TA PËRJETUAR ATA NJË PJESË TË ASAJ TË KEQEJE QË E BËNË, ASHTU QË TË TËRHIQEN (NGA TË KËQIJAT).”

shumë se kaq do të ndodhë!” I thanë: E çfarë mund të jetë më shumë se kaq? Tha: “Si do të veproni atë ditë, kur nuk do të urdhëroni më për të mirë dhe s’do e ndaloni më të keqen?” I thanë: A do të ndodhë kjo, o i Dërguar i All-llahut? Tha: “Edhe më shumë se kaq do të ndodhë!” I thanë: E çfarë mund të jetë më shumë se kaq? Tha: “Si do të veproni atë ditë, kur do të urdhëroni për të keq dhe do ta ndaloni të mirën?” I thanë: Edhe kjo do të ndodhë, o i Dërguar i All-llahut? Tha: “Edhe më shumë se kaq do të ndodhë!” I thanë: E çfarë mund të jetë më shumë se kaq? Tha: “Si do të veproni atë ditë, kur do ta shihni të mirën të keqe dhe të keqen të mirë?!”

Ndërkohë, thoshte: “Do të urdhëroni për të mirë dhe do të ndaloni të keqen, ose do t’ju ndëshkojë All-llahu me më të këqijtë në mesin tuaj, atëherë do të luten më të mirët në mesin tuaj dhe s’do t’u përgjigjet!”

Është e frikshme të mendosh se sot, sa herë dëgjon debate politike, sociale e kulturore, do të dëgjosh se kryeministri, presidenti, kryetari i Bashkisë, deputeti, drejtori, avokati, gjyqtari, prokurori, polici, imami, myftiu, etj., është hajdut, i korruptuar, mashtrues, i degraduar, i përdalë... Çfarë mbetet pas kësaj? Dilni një pasdite dhe bëni një xhiro nëpër rrugët e Shkodrës dhe lokalet e saj, për të parë se si jemi katandisur!

Prandaj, le të kthehemi me pendim të sinqertë nga Zoti i gjithësisë dhe të kërkojmë falje, të angazhohet secili për të urdhëruar për të mirë dhe për të ndaluar të keqen, jo për të thënë secili se mua nuk më duhet se çfarë bëjnë të tjerët!?

Mos dëgjoni deklaratat e atyre që shesin nderin kombëtar para perëndimorëve, teksa u thonë se jemi shoqëri laike; atyre që e kanë Islamin halë në sy! Lërin ata në hutimin dhe kllapinë e tyre! Ne jemi muslimanë dhe duhet të kemi prioritet kryesor në jetë fitimin e kënaqësisë së All-llahut, Zotit tonë, jo plotësimin e epsheve dhe tekave të njërit a tjetrit në kurriz të fesë!

Fenë duhet ta kemi kufij pa tolerancë! Nëse e shesim edhe fenë për një hap më shumë drejt prishjes dhe degjenerimit, atëherë kemi humbur këtë jetë dhe të ardhmen!

Zoti na ruajtë ne dhe fëmijët tanë, rininë dhe shoqërinë tonë nga prishja dhe devijimi!

(Hytbeja e xhumasë, mbajtur në xhaminë e Parrucës, më 31 gusht 2018)

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT 1439/2018

Të dashur dhe të shtrenjtë vëllezër dhe motra besimtarë, bashkëqytetarët e mi shkodranë!

Më lejoni që nga kjo fushë e begatë e Arefatit, në këtë ditë të madhnueshme të Arefatit, në prag të Kurban Bajramit t’ju uroj me zemër, që Zoti i gjithësisë të zbresë mëshirën e Tij të pakufishme, faljen e Tij, dashninë e Tij, bekimin e Tij mbi gjithsecilin prej jush, mbi familjen tuaj, mbi vendlindjen tonë, mbi krejt njerëzimin.

Tashmë jemi përgjigj All-llahut të Madhëruar me telbijen e shenjtë, duke thënë “Lebejkall-llahumme lebejk” dhe me ihrame te bardha kemi ardhur drejt këtij vendi të shenjë për t’u lutur bashkërisht me miliona besimtarë muslimanë nga mbarë globi, të cilët tubohen sot në një ditë të pashembullt adhurimi. Në një ditë të jashtëzakonshme besimi dhe përlujeje e dorëzimi para thirrjes së Zotit të gjithësisë.

Të dashurit e mi!

Të gjithë ne kemi nevojë për t’ju përgjigjur në çdo moment të jetës sonë thirrjes së Zotit, i Cili na udhëzon dhe na merr për dore drejt asaj, e cila është më e mira; larg veseve, larg alkoolit, larg bixhozit, larg shkatërrimit të familjes, larg imoralitetit, larg afetarizmit, larg çdo gjëje që e shkatërron mendimin, logjikën, mendjen, arsyen, shpirtin, zemrën, trupin dhe ekonominë e njeriut mbi tokë.

Të dashurit e mi!

Unë lutem me zemër nga ky vend i shenjtë që All-llahu i Madhëruar t’ju begatojë e t’ju udhëzojë drejt dritës

së Tij. Ne kemi nevojë sot për një rimëkëmbje të madhe, e një rizgjim të madh e të fortë, për t’u rikthyer tek rrënjët e besimit tonë për t’u rikthyer tek vlerat konkrete të besimit tonë, për të dëshmuar realisht në jetën tonë të përditshme, madhështinë e këtij Islami, për t’i rikthyer hijeshinë dhe pashinë, dritën dhe madhështinë Shkodrës tonë, Shqipërisë tonë; kudo që të jemi me vlerat më të mira morale dhe kombëtare që burojnë nga ky Kur’an, nga ky Islam i pastër, nga kjo dritë e pushuar, e cila udhëzon dhe ndriçon njerëzinë nga momenti i krijimit të njeriut të parë dhe do të vazhdojë ta bëjë deri në ditën e fundit.

Të dashurit e mi!

Ju ftoj me zemër që të luteni për njeri-tjetrin, e të punoni për njeri – tjetrin, të punojmë për harmoninë në mesin tonë e të punojmë për vlerat që na bëjnë të dëshmohemi si popull i qytetëruar, popull besimtar, popull i distancuar nga keqja!

Ne kemi lidhur zemrat me Zotin e gjithësisë, i jemi përgjigjur All-llahut të Madhëruar me telbijen e shenjtë, jemi veshur me të bardha e shpresojmë që e bardha të na karakterizojë në çdo moment, çdo sekondë e minutë të jetës sonë, sa të jemi në këtë botë e sa të jemi në këtë jetë kalimtare.

Ju dua me zemër dhe ju përsëndes nga vendet e shenjta!

Allahu ju dashtë e ju bekoftë!

Me zemër të mirë Kurban Bajramin!

Imam Muhamed Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

Arefat, 20 gusht 2018





Shejkh Muhamed El-Gazali

LE TA DINË NJERËZIT E FESË!

“E, unë nuk e di, a keq po dëshirohet për ata që janë në tokë, apo kërkon për ta, Zoti i tyre, udhëzim”. - (Kur’ani, El-Xhin: 10)

Njerëzit e fesë nuk patën dot sukses në krijimin e një brezi besimtarësh me ndjenja të zjarra dhe entuziazëm rinor, të cilat të lidhin me Allahun përmes dashurisë, dëshirës dhe mahnitjes. Në fakt, përpjekja e tyre ka qenë e drejtuar në frikësimin e njerëzve nga Krijuesi i qiejve dhe për t’i bërë ata të kuptojnë, se cilësia e parë e Allahut të Madhëruar është, se Ai është i Plotfuqishmi i qiejve dhe i tokës, që dërgon kadere të ashpra, dispozita të rënda dhe gjendje të ndryshme, të cilave nuk u dihet urtësia dhe nuk u kuptohet arsyeja.

Njohja e njerëzve me Zotin në këtë mënyrë nuk është akide e suksesshme dhe nuk ndërton vepra frytdhënëse, por më parësore do të ishte të lidhen zemrat e njerëzve me Allahun përmes metodës së vet dashurisë, përmes mahnitjes së lavdisë së Tij, përmes ndjesisë së krijimit të Tij dhe pohimit të mirësive të Tij.

I Dërguari i Allahut (a.s) e ka pasur zemrën të lidhur me Allahun përmes kësaj metode. Kur binin shirat e parë në dimër, ai dilte në shi me rrobat e tij duke thënë: “Ky shi është krejt i ri prej Zotit të tij”. Kjo është një fjalë që shpreh atë që është në zemrën e të zotit të saj prej përmallimit për Zotin dhe të Dashurin e tij. Kështu, vepronte edhe kur dilnin frutat e para, sepse edhe ato janë krejt të reja prej Atij që i ka krijuar, me ngjyra të mahnitshme dhe shije të mrekullueshme. E, kur iu afrua vdekja, ai psherëtiu duke u përgëzuar: “Tek Prania e Lartmadhërishme”.

Mbi bazën e këtij shembulli dhe kësaj metode, i Dërguari i Allahut i edukonte shokët e tij dhe mbillte në zemrat e tyre farën e dashurisë së patundur për Zotin e tyre dhe për fenë e Tij të madhe. Me të vërtetë, kjo dashuri dha frytet e saj të pjekura. Të parat në mirësi. Shumë larg të keqes. Mbrojtëse të së vërtetës. Durimtare në fatkeqësi. Dëshiruese (të gatshme) për sakrifikim. Të ekuilibruara gjatë vërshimit të mirësive në lumturi dhe gjatë mungesës së tyre në vështirësi.

Gjithë këto rezultate nuk kemi për të arritur tek asnjë prej tyre, ose disa prej tyre, nëse e ndërtojmë besimin përmes frikës së panjohur dhe tmerrimit të fshehtë.

Sigurisht, që nuk e mohojmë faktin se feja e pastër i bashkërendit mësimet e saj në shumë raste, me frikësim, me tërheqje vëmendjet dhe ndezjes së shkëndijave, por këto ashpërsi zënë vende të kufizuara në edukimin e nefsit (egos), ndalimit të epshit dhe luftimit të krimit, e nuk janë baza e parë parandaluese prej metodave të edukimit të saktë.

Kur’ani Famëlartë i mëson shpirtat dhe i formëson ato mbi bazën e njohjes së Allahut me çfarë dërgon prej mëshirave dhe shpërndan në tokë prej bereqeteve. Këto palosin përmendjen e të këqijave dhe nuk i deklaron duke ia mveshur Allahut, ndërkohë që përmend qartë të mirat duke thënë: “E, unë nuk e di, a keq po dëshirohet për ata që janë në tokë, apo kërkon për ta, Zoti i tyre, udhëzim”. - (Kur’ani, El-Xhin: 10)

Prandaj, le ta dinë njerëzit e fesë si ta bëjnë Allahun të dashur për njerëzit, sepse metodat e tyre përfshijnë braktisjen e fesë dhe largimin prej saj.

(Nga libri: “Meditime në fe dhe jetë”)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja



NË MËNGJES DO KALOJ NGA SHITËSI I LULEVE, TË TË BLEJ NJË JETË ME JASEMINË...

Pasdreken e sotme në Al-Jazeera Documentar, po shfaqej një dokumentar kushtuar Damaskut, kryeqytetit sirian, vendit të shtrenjtë të minareve, dijes e dijetarëve, qytetërimit dhe modelit më elitare të besimit të jetuar në përditshmërinë e krejt shtresave të njerëzve, që teksa thithin oksigjenin e pastër të një vendi të bekuar, dëshmojnë së bashku paqen e të jetuarit në një tokë të lashtë, që të parët tanë e njihnin si: Shami Sherifë...

“Damasku – Simfonia e një qyteti...”, titullohej dokumentari që më magjepsi me notat e fshehura të mallit e nostalgjisë për një tokë e një vend, sa një mirazh kohësh të pamatura...

Kaderi im dhe i shumë arnautëve të tjerë ndër shekuj, u bë shkëndijë e pakuptueshme dhe e pavullnetshme, por fatlume, që lidhi zemrat dhe nostalgjinë me emrin e madh e të pazëvendësueshëm të këtij vendi dhe tokës së tij të begatë...

Ishte verë e mbrame e vitit 1993, kur për herë të parë shkela në këtë prag të lashtë, sa lashtësia e njeriut mbi tokë. Ishte aksham, dielli s’kishte shumë që kishte përënduar. Qyteti ishte dritë. Një ditë e re, që po niste me magribin e asaj nate, shënoi në ballë të rrugëtimit tim adresën e jetës, nurin e saj...

Vulosi veten dhe hapërimet e mia me dritën dhe frymën e jaseminës, dritës jeshile të minareve, ngjyrën e mihrabeve dhe jehonën e lutjeve të prag sabaheve, që mbulonin horizontet me pelerinën e mekameve të tyre mistike, në prag të dritës së re të një dite që kish nisur me perëndimin e diellit të saj...

Dokumentari më mori për dore drejt atij viti të largët dhe shumë të tjerëve që e pasuan, për të parë më sytë e kujtesës dhe mallit, vende dhe njerëz, që në jetën time shënuan kthesa dhe lanë gjurmë, prej atyre që ngajnë me gdhendjet në gur, që asgjë nuk i prish, as ia humbë formën dhe bukurinë e papërshtueshme...

Damasku ishte dhe mbeti emër i shtrenjtë, tamam si Shkodra, vendlindja ime... Damasku me rrugicat e veta, me penxheretë karakteristike, me gjurmët e qytetërimeve të lashta, me frymën elitare të besimit dhe kulturën e tij, mishëruar në çdo gjë...

Damasku i paqes dhe i sigurisë, i burrave me integritet dhe grave fisnike, rinisë së qeshur dhe fëmijëve të edukuar e brumosur me edukatën e gjyshërve besimtarë e qytetarë të mirë, që ditën e nisin me namazin e sabahut në xhami, lutjet e paqta për njëri-tjetrin, vrapimin

drejt punës dhe angazhimeve ditore, pajisur me frikën dhe dashninë e Zotit, me qëllime fisnike; duke e konsideruar punën e pastër adhurim; fitimin me djersën e ballit, afrim me Zotin; ruajtjen e harmonisë në komunitet, dëshmi qytetërimi dhe etiketë prezantuese e një Qyteti, jo si çdo qytet, emri i të cilit thirret DIMESHK, a Damask, siç e njohin axhemët në mbarë botën...

Dokumentari, (që për hir të së vërtetës, mbaroi para se të fillonte), më trazoi kujtimet dhe nostalgjinë, më ftoi të ulem e të shkruaj këto rreshta, si një copëz testamenti, që nuk mund të sosë kaq me nxitim, për të shprehur atë që realisht fshihet në zemër nga dashnia dhe përulja, për një vend që peshon sa shumë vendlindje, për një kohë, që s’ka peshore në botë që ia përkufizon dot vlerën, për një frymë malli, që sa herë shfaqet i ngacmuar nga jashtë, vërshon paqësisht, duke mbuluar me miskun e tij gjithësinë, para së cilës dukem shumë i vogël, aq sa për të mos u dukur e për të mos u vënë re...

Damask, ishte dhe mbeti një emër simfonie, prej atyre që luhen një herë në jetë pa u shkruar në pentagrame e, që s’ka pentagram që ia mbledh dot notat, para tingujve të cilëve gjithësia mban heshtje, mbështetur në prapen e Jaseminës dhe Zambakut...

Damask, ishte dhe mbeti emër qytetërimi dhe shpirti, virtytesh dhe morali, dijes dhe dijetarësh, veprash dhe sakrificash, harmonie kulturash, përzier me sinqeritet burrash të mëdhenj e hijerëndë, mëkuar nga zemra nënash zemërgjera e plot urti shekujsh mbi supe, prej atyre që përkundin qytetërimet, me sytë përtokë e zemrat drejtuar nga qiejt dhe lartësitë e tyre të bardha...

Ishte verë e mbrame e vitit 1993...

Lëvizja e njerëzve ruante një dinamikë, që buronte nga mexhliset e dijes, të tejmbushura me të rinj e të reja, me baballarë, fytyrat e të cilëve zbukuroheshin me një palë mustaqe të hijshme, a mjekra të lehta të mirëmbajtura, teksa i shihje duke nxituar për të zënë një vend të merituar, aty para duarve të mjekërbardhëve me çallmat e dijes dhe përkushtimit, me fytyrën dritë...

Damasku i përngjet asaj që shkruan Mustafa Sadik Rrafiu (1298-1356 h.) në kryeveprën e tij: “Revelata e lapsit”, në esenë me titull: “Histori që flet”, kur

thotë: “Janë ca ëndrra, që në të vërtetë janë tregime logjike të plotësuar në pjesë, të vulosura në kallëpet e veta, të mirëstrukturuara, të shkruara mrekullisht, që e bëjnë njeriun, teksa flen, si ta kishte dorëzuar veten e tij në duart e një shoqërie melekësh, që e ndihmojnë të notojë në një botë të çuditshme, si të ishte magjepsur dhe të ishte kthyer në një tregim.

Nëse ndër lexues ka prej atyre që s’e dijnë këtë, le ta dijnë tani prej meje; sepse shpeshherë unë shkruaj dhe lexoj në gjumë dhe, shpeshherë frymëzohem nga Krijuesi i fjalës dhe, shpeshherë shoh atë, që po ta kisha regjistruar me shkrim, do të konsiderohej prej mrekullive...”

Kështu është Damasku, që sa herë përmendet, vetvetiu kthehem në një udhëtar të heshtur në rreshtat e historisë, muhaxhir i dashuruar pas shfaqjes së jaseminës dhe zambakut, minareve të vjetra me gurë shekujsh, perëndimit të diellit mbështetur mbi Kasijun, rrjedhës së burimit të Fixhës, freskisë së Beradasë, mekameve të eulijave të kohës, ezaneve kumbues me zë shpirti, që ta zgjojnë zemrën prej hutimit dhe ta gjallërojnë shpirtin me jehonën e përhapur horizonteve të përmalluara për thirrjen e teuhidit...

Kështu, sa herë përmendet e shfaqet nami i tij, aq herë më vjen në hatër i madhi Nazim, në vargjet e të cilit gjej prehje, shfryej mallin tim e gjurmëve të sokakut të vjetër shkel, në besë të viteve e kohës që kaloi...

Me hakikat të jam ashik

Gjithë jeta le të dinë,

Hiç ai që është ashik

A e msheh ashikërinë!

...

Dhé e qiell le ta dinë

Se me kë jamë bërë ashik,

Pse ta pshehnje ashikërinë

Një insane që është sadik.

Zotynë e di sa të dua

Më nukë kam se si them,

Puna ime u dëgjua

U çel nëpër gjithë alem...

Ishte verë e mbrame e vitit 1993...

Në mëngjes do kaloj nga shitësi i luleve, të të blej një jetë me jaseminë...

Muhamed B. Sytari

Shkodër, 24 korrik 2018



Naim Drijaj,
Imam - xhamia Parrucë

Burimi hyjnor i Islamit, Kur'ani, thekson rëndësinë e koncepteve të moralit, dashurisë, mëshirës, përkushtimit, sakrificës, tolerancës dhe paqes. Muslimani që i zbaton siç duhet në jetën e tij këto parime, bëhet një njeri i sjellshëm, i thjeshtë, i drejtë, i besueshëm dhe me të cilin mund të krijohen marrëdhënie të sigurta. Ai reflekton përreth tij dashuri, respekt, harmoni dhe kënaqësi.

Morali është një ndër elementet kryesore që formojnë një musliman të vërtetë, të edukuar dhe të vetëdijshëm rreth parimeve islame.

Çdo civilizim, ka si kusht tre gjëra në mënyrë që të mbijetojë dhe të zhvillohet. Ato kushte janë financiare, shpirtërore dhe morale. Popujt do të ekzistojnë për sa kohë që do të ruajnë parimet dhe bazat e moralit. Kur ato rrënohen, mos pyet pse zhduken popujt.

Morali i mirë zë vend të rëndësishëm në fenë tonë dhe është sekret i dhënë nga Zotë (xh.sh) e dërgoi profetin Muhamed (a.s). Këtë e ka pohuar vetë Pejgamberi (a.s) kur ka thënë “Jam dërguar për të përsosur moralin e njeriut”.¹

Islami është feja e moralit. Allahu (xh.sh) e krijoi njeriun duke i dhënë formën më të bukur. “Vërtet, Ne e krijuam

1. Transmetuar nga Buhariu në “Edebul Mufred”.

POPUJT DO TË EKZISTOJNË PËR SA KOHË QË DO TË RUAJNË PARIMET DHE BAZAT E MORALIT

njeriun në formën më të bukur”.² Prandaj, përpiku të kesh edhe moralin më të bukur dhe lutu ashtu siç lutej Pejgamberi (a.s): “O Zoti im, ashtu siç ma ke bërë krijimin tim të mirë, ashtu ma bëj dhe moralin tim të mirë.”³

Njeriu së pari duhet të jetë i moralshëm ndaj Allahut të Madhëruar. Morali me Allahun (xh.sh) përmbledhet në tri gjëra: të besojë atë që Ai shpalli nëpërmjet Kur'anit dhe profetit Muhammed (a.s) të zbatojë mësimet e Tij dhe të jetë i durueshëm dhe i kënaqur me përcaktimin e Tij.

Pastaj vjen morali i muslimanit me vetveten, me prindërit, gruan, fëmijët dhe me njerëzit e tjerë. Të sillet me ta mirë dhe me çiltërsi, të jetë i besueshëm dhe të dojë për ta, atë që do për veten e tij.

Morali i lartë sjell dashuri reciproke dhe afritet me njerëzit, kurse sjelljet e këqija shkaktojnë urrejtje, zili dhe largim nga njëri-tjetri.

Nuk ka dyshim se një shoqëri e fortë dhe e shëndoshë ndërtohet dhe lartësohet vetëm me anë të një moralit të shëndoshë dhe të lartë.

Abdullah ibn Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të ka thënë: “Çdo ndërtesë ka baza e veta dhe baza e islamit është morali i mirë.”

Feja jonë synon të rregullojë tre aspekte kryesore:

1- Aspekti i parë është besimi i njeriut. Feja ka për qëllim të kanalizojë besimin e njeriut. Çdo njeri është besimtar në natyrën e tij, por Islami erdhi për ta drejtuar këtë besim aty ku e pëlqen Allahu (xh.sh).

2- Aspekti i dytë janë marrëdhëniet mes njerëzve. Feja erdhi për të rregulluar këto marrëdhënie.

2. Kur'ani, Et-Tin: 4.

3. Transmetuar nga Ahmedi: 6/68.

3- Aspekti i tretë është morali i njeriut. Feja erdhi për të rregulluar moralin e njeriut, të brendshmen e tij.

Po të studiosh Islamin, po të njohësh thelbin e tij, do ta shohësh se të gjitha adhuret që bëjmë, falja e namazit, agjërimi, haxhi, zekati kanë një qëllim të vetëm: “Të rregullojnë moralin e njeriut”. Ky është qëllimi final, për të cilin ka ardhur feja e Allahut (xh.sh).

Allahu (xh.sh) në Kuranin famëlartë thotë: “Vërtet, namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar”.⁴

Profeti Muhamed (a.s) ka thënë: “Nuk ka vlerë agjërimi i atij njeriu që agjëron, mban barkun bosh, por nuk largohet nga gënjeshtria dhe thashethemet. Allahu (xh.sh) nuk ka nevojë për agjërimin e këtij personi”.⁵ Qëllimi i agjërit është: të rregullojë moralet dhe sjelljet e njerëzve.

Allahu (xh.sh) thotë: “Merr nga pasuritë e tyre zekatin”.⁶ Qëllimi i zekatit është të pastrojë zemrën e njeriut. Po ashtu Allahu (xh.sh) flet për Haxhin: “Kush e ka bërë niset të shkojë në Haxh le ta dijë, se atje nuk ka fjalë të kota, nuk ka debate, nuk ka punë kot”.⁷ Atje ka pastrim zemrash e morale.

Kjo pra është feja jonë. Këto janë bazat e fesë tonë. Ata kanë një qëllim të vetëm, kanë një synim final, të rregullojnë marrëdhëniet e njeriut me njeriun, të rregullojnë moralet e njerëzve.

Prej porosive të Pejgamberit (a.s) ishte edhe fjala që ua drejtoi Ebu Dherit dhe Muadh ibn Xhebelit Allahu qoftë i kënaqur me të dy: “Ke frik Allahun kudo që të jesh, çdo të keqe pasoje me të mirë, ajo e shlyen atë, dhe sillu me njerëzit me moral të mirë”.⁸ Ibn

4. Kur'ani, El-Ankebut: 45.

5. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

6. Kur'ani, Et-Teube: 103.

7. Kur'ani, El-Bekare: 197.

8. Transmetuar nga Tirmidhiu, 4/355.

“O Zoti im,

ashtu siç ma ke bërë krijimin tim

të mirë, ashtu ma bëj edhe moralin tim të mirë.”

Kajimi Allahu e mëshiroftë ka thënë: “I Dërguari i Allahut bëri bashkimin mes devotshmërisë ndaj Allahut dhe moralit të mirë, ngase devotshmëria përmirëson raportin mes robit dhe Zotit të tij, e morali i mirë përmirëson raportin mes tij dhe krijesave. Pra devotshmëria ndaj Allahut i sjell atij dashurinë e Allahut e morali i mirë i thërret njerëzit që ta duan atë”.

Ebu Hafs, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Edukata dhe morali i jashtëm i robit të Allahut është një lloj dëshmie se edhe brendësia (zemra) e tij është e shëndoshë dhe e pastër”.⁹

Aliu (r.a) ka thënë: “Kush i zotëron këto katër virtyte, Allahu do t'ia kthejë punët e këqija në punë të mira. Ato janë: singriteti, turpi, mirënjohja dhe morali i mirë”.¹⁰

Ibn Abasi (r.a) ka thënë: “Morali i mirë i shkrin gjynahet, sikurse dielli që e shkrin akullin. Ndërsa, morali i keq i prish punët, sikurse uthulla që e prish mjaltn”.¹¹

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Asgjë nuk do të rëndojë më shumë në peshoren e muslimanit ditën e Kiametit sesa morali i mirë”.¹² “Muslimani më i mirë është ai që ka moralin më të mirë”. “Besimtari me besimin më të plotë, është ai që ka moralin më të mirë”.¹³ “Ai që do të jetë më afër meje Ditën e Kiametit, është ai që ka moralin më të mirë”.¹⁴ “Gjëja që i çon njerëzit më shumë drejt xhennetit është devotshmëria dhe morali i mirë”.¹⁵ Kur erdhën disa njerëz te Pejgamberi (a.s) e pyetën se kush është njeriu më i dashur tek Allahu. Ai ua ktheu: “Ai që ka moralin më të mirë”.

Vërejmë se në renditjen e haditheve: muslimani më i mirë, besimtari me besimin më të plotë, ai që do të jetë më pranë Pejgamberit (a.s) ditën e Kiametit, njeriu më i dashur tek Allahu etj... Përgjigjja e të gjitha këtyre ishte morali i mirë.

I lutemi Allahut të madhëruar që moralin dhe sjelljen e mirë ta bëjë nga cilësitë tona.

(Fjalimi i mbajtur me rastin e Kurban Bajramit në sheshin pranë xhamisë “Ebu Bekër”, 21 gusht 2018)

9. Medarixh es Salikin, vëllimi 2, fq. 428.

10. Komentimi i 40 Haditheve të Imam Neveviut fq. 234.

11. Po aty, fq. 235.

12. Transmetuar nga Tirmidhiu.

13. Transmetuar nga Tirmidhiu.

14. Transmetuar nga Tirmidhiu.

15. Transmetuar nga Tirmidhiu.

VIZITË XHAMISË “FATIH” NË BRENDI TË KALASË ROZAFË NË SHKODËR

Evlija Çelebiu, në veprën e tij, atë e quan “Xhamia e Sulltan Mehmetit”. Data e ndërtimit nuk i dihet, veçse vlerësohet si ndër më të hershmet. Kurse, At Eresmo Belneo, në vitin 1757 për këtë xhami thotë se ajo ka qenë “xhami e madhe, e bukur...”. Ritet fetare në këtë xhami janë kryer deri në vitin 1865, ndërsa si pronë-vakëf e bashkësisë islame të Shqipërisë ka qëndruar deri në vitin 1967, vit që shteti monist mbylli të gjitha objektet fetare.


Ndryshe kjo ‘Xhami’ në kalanë e Shkodrës prezentohet si ‘Kishë’ ku dje isha dhe vetë dëshmitar i një “ciceroni servil” ku para të huajve flet gënjeshtria të papara. Ç’kënaqësi të qëndrosh pranë kësaj bukuroshe duke brohoritur me tekbire dhe duke shijuar gjurmët

islame. Ndryshe kalaja e Rozafës në Shkodër njihet si qendër e fortifikuar ilire përmendet për herë të parë gjatë sundimit të mbretit Gent dhe historiani Tit Livi e quan “vendi më i fortë i labeatëve”.

Kështjella del me emrin Rozafa në periudhën e mesjetës, gjatë së cilës u pushtua herë nga sllavët dhe herë nga bizantinët. Sidoqoftë më 1478 Sulltan Mehmeti II rrethon Shkodrën me mbi 100.000 ushtarë si kështjella e fundit e pa pushtuar deri atëkohë.

Kështjella Rozafa (kalaja e Shkodrës) u dorëzua me kusht pas marrëveshjes së nënshkruar mes Venedikut dhe osmanëve më 25 Prill 1479.

Bujamin SALIJA, *historian*



Shkrimet autoriale nuk përfaqësojnë detyrimisht mendimet dhe pikëpamjet e gazetës!



Lavdrim Hamja,
Imam - xhamia e "Dy Vajzave"

Zoti është Mëshirues dhe Mëshirëbërës. Ai e krijoi njeriun dhe e dalloi mbi të gjitha krijesat e tjera të Tij, madje e lartësoi shumë lartë racën njerëzore duke bërë zëvendës të Tij në tokë dhe çdo gjë e nënshtroi për të, në mënyrë që njeriu të jetojë i qetë dhe i lumtur në këtë dynja, për aq kohë sa ia ka shkruar vetë Zoti i gjithësisë.

“O ju njerëz, përkujtoni begatitë e Allahut ndaj jush. A ka ndonjë krijues tjetër, përveç Allahut, që ju furnizon prej qiellit dhe tokës? Nuk ka zot tjetër, përveç Tij, prandaj si largoheni (prej Tij dhe prej adhurimit të tij)? – (Kur’ani, Fatir: 3)

“O ju njerëz, ju keni nevojë për Allahun, Allahu është i Panevojshëm, është i Falënderuar”. – (Kur’ani, Fatir: 15)

“A ju njerëz, Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre, e ju bëmë popuj dhe fise, që të njiheni (me njëri-tjetrin). Me të vërtetë, më i nderuar prej jush, tek Allahu, është ai që është më i përkushtuar. Allahu është i Gjithëditur, është i Gjithënjohur”. – (Kur’ani, El-Huxhurat: 13)

I Dërguari i Allahut, Muhammedi (a.s), i fundit i Profetëve të Zotit në vargun e shpalljeve hyjnore, është shembulli më i përkryer i racës njerëzore, i cili arriti, brenda 23 viteve, jo vetëm ta ndreqë dhe ta reformojë një popull nomad dhe të shthurur me plot kuptimin e fjalës, por i bëri ata njerëz yje ndriçues, që i dhanë dritë gjithë botës, duke përhapur besimin në një Zoti të Vetëm, paqen, harmoninë, tolerancën, bashkëjetesën mes feve të ndryshme, respektimin e vëllait të tij njerëzor, e duke larguar errësirën, zullumin, skllavërinë, luftërat etj.

Ky Profet i fundit, të cilin Zoti e dërgoi mëshirë për mbarë botët: “Ne, nuk të dërguam ty, vetëm se mëshirë për botët”; dhe të cilin e bëri shembullin më të mirë për tu ndjekur: “Me të vërtetë, në të Dërguarin e Allahut është shembulli më i mirë, për atë që shpreson Allahun dhe

VETËM AJO, QË ËSHTË SHPALL PREJ ZOTIT ËSHTË E VËRTETË DHE E SAKTË

ndërsa gjithçka tjetër, përveç saj, është e kotë dhe zullum!

Ditën e Fundit”, me jetën dhe veprën e tij, i ka treguar gjithë botës dhe mbarë njerëzimit, se mund të transformohet një popull, madje i gjithë njerëzimi, përmes besimit dhe bindjes, e jo përmes dhunës dhe forcës, nga njerëz armiqësor dhe shtypës të njëri-tjetrit në vëllezër dhe dashamirës të njëri-tjetrit. Historia botërore e njerëzimit nuk ka njohur asnjë shembull të tillë, siç ndodhi me popullin arab të asaj kohe, të cilët Pejgamberi (a.s) arriti t’i bashkojë, t’i vëllazërojë, t’i ndriçojë, t’i udhëzojë drejt dinjitetit, drejtësisë, vëllazërisë, harmonisë, mëshirës, dhembshurisë dhe përparimit. Ishin këta besimtarë të sinqertë në besimin dhe në fenë e tyre, të cilët i dhanë botës dhe mbarë njerëzimit dritën e nevojshme, duke i çliruar nga tiranët dhe shtypja, e duke i lënë të lirë në besimin dhe fenë e tyre.

Shejkh Muhamed El-Gazali e përshkruan kështu edukimin, që i Dërguari i Allahut (a.s) bëri ndaj sahabëve të tij: “Ishte dashuria e buruar nga zemra e të Dërguarit fisnik (a.s), e cila i shndërroi zemrat nga një gjendje në tjetrën, prandaj a do të mësojnë thirrësit prej Pejgamberit të tyre, të bashkojnë në vend që të përçajnë, të përgëzojnë në vend që të largojnë??.

Prandaj, nuk është për tu çuditur, kur lexojmë, se Ebu Bekri (r.a), kalifi i parë i myslimanëve, kur e mori postin e kalifatit tha: Ebu Bekri (r.a): “O ju njerëz, unë u emërova kalif, por nuk jam më i mirë ndër ju. Binduni mua për aq kohë sa unë i bindem Allahut, për ju, por në qoftë se i bëj mëkat Atij, atëherë nuk e keni detyrë të më bindeni.”

Po ashtu, edhe Umer ibnul-Hatabi, i cili e kuptonte postin e kalifit si përgjegjësi të madhe dhe të rëndë, thoshte:

Ndërkohë, Umeri ibnul-Hatabi (r.a), e ndjente përgjegjësinë e postit, deri në këtë masë, sa që thoshte: “Sikur një bagëti të rrëzohet në Irak, kam frikë se Allahu do të më pyes: O Umer, përse nuk ia ke rregulluar rrugën asaj?”

TË NDERUAR VËLLEZËR DHE MOTRA BESIMTARË,

Sa herë që njerëzimi ka devijuar nga rruga e Zotit dhe Krijuesit të tij, e ka çuar veten drejt shkatërrimit dhe degradimit. Historia botërore është dëshmitarja më e mirë dhe më e sinqertë, e cila na dëshmon, se kur njeriu braktis besimin në

Zot e braktis atë mënyrë dhe sistem jete, të cilën Krijuesi e ka vendosur, njeriu rrëshqet shumë poshtë duke degraduar dhe duke shkatërruar veten e tij me duart e tija.

Për gjendjen e njerëzimit të kohës moderne, Shejkh Ahmed Kuftaro do të shprehej: “Njeriu i sotëm ka frikë prej vëllait të tij njeri dhe miqësinë e tij e ka gjetur te kafshët e pyllit, të cilat nuk sulmojnë askënd, përveç se atëherë kur janë të uritura. Edhe poeti thotë: Ujku ulëriu dhe gjeta miqësi me ujkun kur ai ulëriu. Njeriu bërtiti dhe gati sa nuk fluturova...”

“Dhe prej argumenteve të Tij, është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe ndryshimi i gjuhëve e i ngjyrave tuaja. Me të vërtetë, në këtë ka argumente për njerëzit e ditur.” (Kur’ani, Err-Rrum: 22)

“Kjo llojshmëri, në të cilën Allahu i krijoi njerëzit, nuk duhet të bëhet shkak për ndarje, përçarje, grindje dhe armiqësi. Njerëzit e mençur mund të bëjnë llojshmërinë (ndryshimin) shkak të solidaritetit dhe ndihmës për njëri-tjetrin në interes të së mirës dhe të vërtetës.

Këtë të vërtetë, të cilën e gjejmë në jetën e Pejgamberit (a.s) në formën më të plotë, duhet të kërkojmë në të arsyet e unitetit dhe bashkimit tonë.”

Me të vërtetë realiteti i botës së sotme, e cila është zhytur në labirinte të errëta dhe pa rrugëdalje, dëshmon për nevojën e madhe që ka njerëzimi sot, për tu kthyer nga besimi dhe rruga e Zotit. Nuk ka krijesë në botë, që të bëjë krime siç po bën njeriu. Nuk ka krijesë në botë që të bëjë shkatërrime në tokë siç po bën njeriu, të cilin Zoti e bëri zëvendës në tokë dhe ia ngarkoi amanetin e kësaj bote. Nuk ka krijesë në botë, që ta dëmtojë racën, apo llojin e vet, siç po bën njeriu me racën dhe llojin e tij. Edhe pse krijesat e tjera nuk e kanë logjikën e njeriut, ata përsëri nuk arrijnë të bëjnë ato krime dhe shkatërrime siç po i bën raca njerëzore. Njeriu po helmon dhe po mbyt vëllanë e tij njeri me gjithfarë lloj dogrash, pijesh e ushqimesh të ndyta e prishura. Njeriu, me lakminë e tij, nuk po lë të jetojë vëllanë e tij, duke ia grabitur pronën, pasurinë, tokën dhe vendin e tij.

TË NDERUAR VËLLEZËR DHE MOTRA BESIMTARË,

Për çdo ditë jemi dëshmitarë të shumë ngjarjeve të hidhura që po ndodhin

anekënd globit tokësor. Katastrofa natyrore, si tërmete, zjarre, përmbytje, vrasje makabre e të tjera fatkeqësi, duke marrë jetën e qindra njerëzve në botë. Dhe këto dukuri duket se nuk kanë të ndalur, por kalojnë nga një vend në tjetrin dhe shtohen prej vitit në vit.

Njeriu i sotëm, po përparon vetëm në aspektin material, ndërsa në aspektin shpirtëror dhe moral, ai jo vetëm ka ngelur në vend, por siç ka thënë Dr. Mustafa Mahmud: “Me aq sa kuptoj unë, më duket se ne po përparojmë vetëm në mjete, mekanikë, elektricitet, elektromagnetikë... por ne si njerëz po ecim prapa... nuk ka dashuri, nuk ka humanizëm... njerëzit po hanë njëri-tjetrin me thikë dhe me përu.”

Vërtet të vjen keq për humbjen e jetëve të pafajshme të shumë njerëzve dhe çdo njeri i mëshirshëm bashkohet dhe solidarizohet me dhimbje ne tyre, por nga ana tjetër duhet të përpiqemi dhe të sakrifikojmë që ta ndalim shkatërrimin e tokës në të cilën jetojmë dhe të cilën Zoti ynë e rregulloi në formën më të mirë.

Njeriun ka filluar ta mashtrojë zhvillimi i teknologjisë dhe mendon se mund të nxjerrë ligje, apo të zbulojë forma të tjera të jetës jo në atë formë që Krijuesi e ka vendosur për të jetuar. Por, është e pamundur dhe kurrë nuk do të mund t’ia arrijnë as xhindet dhe as njerëzit që të sjellin diçka më të mirë se sa Zoti e ka vendosur për ne.

“A nuk e di Ai që krijoi? Dhe Ai është i Gjithëdituri. Ai është që juve tokën ua nënshtroi, ecni nëpër të dhe hani prej furnizimit të Tij, e tek Ai do të ringjallen. A u siguruat ju prej Atij që është në qiell, që të mos ju shembet toka kur ajo është duke lëvizur? A u siguruat ju prej Atij që është në qiell, që të mos lëshojë kundër jush rrebesh gurësh? Do ta kuptoni, do ta kuptoni se si është ndëshkimi Im! Edhe ata që ishin para tyre përgënjeshtroan, por si ishte dënimi Im!” (Mulk: 14-18)

O njerëz, Krijuesi ynë na ka ndaluar të bëjmë shkatërrime. Ai na ka ndaluar disa gjëra, sepse ato shkaktojnë dëme dhe shkatërrime në tokë, në det dhe në njerëz. Ai i ka ndaluar gjërat e këqija, sepse ato e prishin rendin e jetës shoqërore mes njerëzve dhe e prishin ekuilibrin e vendosur nga Krijuesi i Gjithëditur dhe Fuqplotë. Prandaj edhe Ai thotë:

“Me të vërtetë alkooli, bixhozi, idhujt dhe hedhja e fallit janë vepra të pista nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre në qoftë se doni të shpëtoni”. (Maide: 90)

Sa aksidente rrugore, sa vrasje, sa krime familjare po ndodhin çdo ditë prej përdorimit të alkoolit! Sa çifte janë

divorcuar, sa familje janë shkatërruar, sa vjedhje e sa grabitje janë rezultat i lojërave të bixhozit dhe të fatit! Përse njerëzit nuk e kuptojnë dhe nuk ndalen e të mendojnë pak se çfarë po u shkaktojnë këto vepra të pista. Përse nuk e kuptojnë, ose bëjnë se nuk e kuptojnë se shpëtimi prej tyre nuk është të kufizohet moshë, koha apo vendi ku pihet alkooli, droga dhe luhet bixhozi, por të ndalohen rreptësisht.

Sa humbje dhe sa vuajtje është duke pasur rendi i ri botëror për shkak të përdorimit dhe konsumimit të atyre gjërave që Zoti i ka ndaluar. Le ta dinë mirë njerëzit se nuk ka rrugëdalje prej këtyre sëmundjeve shoqërore, përveç se duke u kthyer të ligjet e Allahut (xh.sh), të cilat i ka vendosur për të jetuar të qetë, të lumtur dhe të shëndetshëm.

I Dërguari jonë, Muhammedi (a.s), na ka paralajmëruar për vuajtje dhe dënime të ashpra, që njerëzimi do të vuajë, nëse veprohen dhe shfaqen hapur punët e pamoralshme dhe të këqija dhe njerëzit tregohen indiferent në pengimin dhe ndalimin e tyre.

Abdullah ibn Umer ibnul Hatabi (r.a) tregon: Isha i 10-ti në mes të 10-të muhaxhirëve duke ndenjur me Pejgamberin (a.s), i cili na u drejtua duke thënë: “O muhaxhirin, pesë gjëra për të cilat e lus Allahun të mos i arrini:

1. Kur të shfaqet hapur imoraliteti në një popull, atëherë ata do të sprovohen me sëmundje dhe dhimbje që nuk ka qenë kurrë më parë.
2. Kur njerëzit të mashtrojnë në matje dhe në peshore, atëherë do të sprovohen me vite të vështira, mungesë ushqimi dhe diktatura.
3. Kur njerëzit të ndalojnë dhënien e zeqatit të pasurisë së tyre, atëherë do t’u ndalohet shiu prej qiellit dhe sikur të mos ishin kafshët kurrë nuk do tu binte shi.
4. Kur njerëzit thejnë besën dhe premtimet, atëherë Allahu do tu çojë udhëheqës nga jashtë, të cilët do tu grabisin pasurinë e tyre.
5. Dhe kur imamët të mos punojnë me atë që Allahu e ka zbritur në Librin e Tij, atëherë Allahu do tu hedhë mes tyre përçarje dhe armiqësi.” (Ibn Maxhe)

TË NDERUAR VËLLEZËR DHE MOTRA BESIMTARË,

Shumë njerëz sot, duke u justifikuar me liritë dhe të drejtat e njeriut kanë kaluar çdo kufi të logjikshëm të moralit dhe sjelljes njerëzore. Ata mendojnë se njeriu është i lirë të bëjë dhe të veprojë çfarë të dojë, sepse ashtu i pëlqen atij, por ata harrojnë pasojat dhe ndikimet

që do të kenë në jetën shoqërore mbi sipërfaqen e rruzullit tokësor.

“Ju jeni mysafir në këtë planet. Secili nga ju jeni vizitor kalimtar. Fati juaj në këtë botë është kalim i shkurtër. Ju jeni të ftuar. Ju ka ftuar Allahu për të kaluar një ditë në mbretërinë e Tij.

A lakmon më shumë mysafiri se sa një mikpritje të mirë?? A e zë kalimtari veten e tij me grumbullimin e pasurisë si barrë e tij?? Apo ecë si flutura nëpër kopshtet e Allahut”!! - (Dr. Mustafa Mahmud nga libri: Tufani)

TË NDERUAR VËLLEZËR DHE MOTRA BESIMTARË,

Nuk ka dyshim se shpëtimi prej veseve të këqija, të cilat e kanë mbuluar shoqërinë, madje shpëtimi i mbarë njerëzimit, është kthimi në besim dhe ecja sipas ligjeve të Zotit, Krijuesit të gjithësisë.

Dr. Seid R. El-Bouti: “Nuk ka dyshim se Islami i vërtetë, s’është ai rreziku për Perëndimin, ose për qytetërimin perëndimor sot, por përkundrazi ai është “antibiotiku”, i cili mbron qytetërimin perëndimor nga shkatërrimi dhe e shëron atë nga sëmundjet parazitare të përhapura sot dhe e rikthen atë në fillimin e fuqisë e të rinisë së saj, n.q.s Perëndimit do t’i jepej mundësia të mbështetej në të, ose ta kuptojë atë me të vërtetë.

S’ka aspak dyshim se rreziku i vërtetë, i cili është në pritje të qytetërimit perëndimor, është fesadi (prishja, degjenerimi) dhe është i njëjti shkak, i cili depërtoi në perandorinë romake ku pastaj e ekzekutoi atë me vdekje”.

Po e mbyll me fjalën e Shejkh Jusuf El-Karadavi, i cili thotë se: “Mesazhi i Islamit është mesazh botëror, mesazh për çdo racë, për çdolloj ngjyre, për çdolloj vendi, për çdolloj popull, për çdolloj gjuhë dhe për çdolloj shtresë: “Dhe nuk të dërguam (o Muhammed), veçse mëshirë për mbarë botët”.

Allahu i Madhëruar na udhëzoftë drejt më të mirës, na begatoftë me mirësitë e Tij dhe na bëftë prej besimtarëve të mirë, që kanë moralin e bukur. Zoti i Madhëruar e paqtoftë mbarë botën, sidomos ato vendi, të cilat vuajnë prej konflikteve të armatosura, siç është Siria dhe na i mbushtë zemrat me dashuri dhe dhembshuri për njëri-tjetrin.

Le të gëzojmë në këtë ditë të begatë të Kurban Bajramit me zemra të pajtuara dhe përkrahje për njëri-tjetrin, sidomos për njerëzit në nevojë.

Gëzuar Kurban Bajramin!

Shkodër, 21 gusht 2018

PALESTINA, KRONOLOGJIA HISTORIKE E SAJ, DERISA ATY ERDHI ISLAMI

Kur përmendet Palestina, menjëherë në mendje të vjen veçoria e saj si “Tokë e Shenjtë” dhe si “ Tokë e Bekuar” nga Krijuesi i Gjithësisë.

Ajo është toka të cilën Zoti i Gjithësisë e bëri strehë për profetin e Tij të zgjedhur, Ibrahimin, alejhi selam. Ajo është toka ku lindën e u rritën një varg profetësh, pasardhës të Ibrahimit, alejhi selam.

Ajo është toka nga ky Profeti i Islamit, Muhamedi, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, u ngjiti për në Qiellin e Shtatë, natën e Israsë dhe të Miaraxhit, për t’u takuar me Krijuesin e Gjithësisë, me lejen e të Madhërishmit.

Por sot, kjo tokë po vuan nën terrorin e një grushti njerëzish, të cilët po dhunojnë banorët e Tokës së Shenjtë dhe faltoret e atij vendi, me pretendimin se ai vend u përket vetëm atyre. Duke u bazuar në pretendimet e tyre, ata nuk u kursyen të dhunojnë burra, gra, pleq e fëmijë, duke i nxjerrë nga toka dhe nga shtëpitë e tyre, të cilat i trashëguan brez pas brezi, nga gjyshër e stërgjyshër.

Palestina sot është simbol i një konflikti pa zgjidhje... Ajo sot është simboli i një plage të hapur të shoqërisë, plagë e cila kërkon shërim... por që nuk po e gjen dot.

Në fakt, kujt i përket realisht kjo tokë? Cilët janë banorët e saj autoktonë? Po këta që e pretendojnë si të tyren, dhe e morën më dhunë e gjak, sa të drejtë kanë mbi të?

* * *

Njeriu ka banuar në tokën e Palestinës që nga kohët e lashta. Atje gjenden gjurmë që 10,000 vjet p.e.s, siç e kemi përmendur edhe më përpara.

Fillimi i mijëvjeçarit të tretë para erës sonë, shënoi lindjen e perandorive të lashta në Lindje, e cila u shoqërua me të shkruarit e ngjarjeve. Kjo ishte koha kur filloi të shkruhet historia. Që këtu fillojnë edhe periudhat historike në Palestinë.

EPOKA E BRONZIT E HERSHME (3300 - 2000 P.E.S)

Periudha që shtrihet mes viteve 3300 - 2000 p.e.s, quhet Epoka e Bronzit e Hershme. Kjo periudhë shënon shfaqjen e qyteteve të fortifikuara, të cilat u ndërtuan mbi reliev të larta dhe u përhapën në numër të madh në atë kohë në Palestinë. Shumica e këtyre qyteteve ishin kryesisht në Palestinën qendrore dhe veriore. Në mijëvjeçarin e tretë para Isait (a.s), popullsia e Palestinës u rrit

ndjeshëm. Qytetet u zhvilluan e u forcuan politikisht edhe ekonomikisht, saqë kjo kohë mund të quhet si “epoka e qytet-shteteve.”¹

Gjatë mijëvjeçarit të tretë pra Isait (a.s), në Palestinë u vendosën Amurejtë, Ken’anët, Jebusejtë dhe Fenikasit. Ken’anët u vendosën në fushat e Palestinës. Ata përbënin numrin më të madh të të ardhurve aty, dhe për këtë arsye Palestina njihet që në kohët e lashta si “Tokë e Ken’anëve”. Amorejtë u përqendruan në male. Jebusejtë u vendosën në Jeruzalem dhe në rrethinat e tij dhe janë këta që e themeluan qytetin e Jerusalemit, të cilin e quajtën fillimisht “Jebus”, ndërsa më vonë “Orselim”. Fenikasit u vendosën në bregdetin verior të Palestinës dhe në Liban.

Sipas historianëve, Amurejtë, Ken’anët, Jebusejtë dhe Fenikasit, kishin ardhur nga Gadishulli Arabik dhe se shumica e popullsisë së sotme palestineze janë pasardhës të këtyre fiseve dhe popujve të lashtë, apo të arabëve dhe myslimanëve, të cilët janë vendosur në vend, pas ardhjes së Islamit aty.

Të gjitha zbulimet arkeologjike, librat e historisë, librat e shenjtë dhe librat e perëndimorëve, e vërtetojnë se banorët e parë të Palestinës ishin Ken’anët dhe Jebusët².

EPOKA E BRONZIT E MESME (2000-1550 P.E.S)

Pastaj erdhi Epoka e Bronzit e Mesme (2000-1550 p.e.s), ku gjysma e parë e mijëvjeçarit të dytë para Isait (a.s), dëshmoi sundimin e Heksosëve³ në Palestinë, gjatë shekujve 18-16 p.e.s..

Sipas shënimeve historike, rreth vitit 1900 p.e.s, në Palestinë erdhi dhe u vendos profeti i Zotit, Ibrahim (a.s). Bashkë me të ishin edhe gruaja e tij, Sara dhe nipi i tij, Luti (a.s).

Ibrahim (a.s), është babai i parë i tyre që sot njihen si hebre dhe babai i parë i këtyre që njihen si muslimanë.

Ibrahim (a.s) ishte nga Babilonia (Irak). Zoti i plotfuqishëm e ndriçoi Ibrahimin duke e udhëzuar në rrugën e besimit të drejtë. Pas përpjekjeve të tij të vazhdueshme, që t’i udhëzonte

1. “Et Tariik ilel Kuds...”, Dr. Muhsin Muhammed Salih.
2. “Felistiin...Et Tarih el Musauar”, Dr. Tarik Es Suvejdan.
3. Hekosët, një popull nomadësh me origjinë të përzier, të ardhur kryesisht nga Azia përendimore (<https://www.dictionary.com/browse/hyksos>)

edhe familjen dhe popullin e tij atje në Babiloni, atë nuk e besoi askush tjetër përveç bashkëshortes së tij, Sara dhe nipit të tij, Luti (a.s). Meqë thirrja e tij për në fenë e vërtetë ndeshi në kokëfortësinë e babilonasve, ai alejhi selam, vendosi të largohej nga vendi i tij. Ai së bashku me bashkëshorten e tij Sarën dhe nipin e tij Lutin (a.s), udhëtuan për në Haran, sot një vend në jug të Turqisë (në veri të Sirisë), ku nuk qëndruan gjatë. Pastaj, ai bashkë me dy ndjekësit e tij, vazhduan udhëtimin derisa zunë vend në Palestinë.

Thotë i Madhërishmi: “Ne e shpëtuam atë dhe Lutin (dhe i çuam) në tokën, të cilën e kemi bekuar për njerëzit.” – (Kur’ani, El Enbija: 71)

Ibrahimi (a.s) zuri vend në Shekim, pranë Nablus-it, dhe që aty u transferua në zonën e Ramallah, pastaj në Kuds. Pastaj kaloi në Halil (Hebron), pastaj në Bi’ir Seb’a, ku qëndroi për një farë kohe, pastaj udhëtoi për në Egjipt. Në Egjipt nuk qëndroi gjatë, por u kthye sërish në Palestinë ku kaloi nga Gaza, pastaj vazhdoi të qëndronte sa në Bi’ir-Seb’a, sa në Halil (Hebron), dhe pastaj zuri vend në Kuds (Jeruzalem). Ndërsa Luti (a.s), u dërgua si profet për zonën në jug të Detit të Vdekur.

Në Palestinë, Ibrahimit (a.s) i lindi fëmija i tij i parë, Ismaili, dhe 13 vite pas Ismailit, i lindi edhe Is’haku, paqja e Zotit qoftë mbi ata të gjithë!

Ibrahimi (a.s) u stabilizua në Palestinë dhe aty qëndroi derisa ndërroi jetë. Ai, (a.s) jetoi dhe u varros në qytetin Halil, qytet i cili e mori këtë emër më vonë (nga cilësia e tij si Halilu-Rrahman), për nder të tij.

Siç e tregojnë librat fetare, djali i tij i madh, Ismaili (a.s), u vendos së bashkë me nënën e tij në Mekën e Shenjtë, dhe atje e kaluan gjithë jetën e tyre. Ibrahim (a.s) i pati vizituar herë pas here.

Ndërsa djali tjetër i Ibrahimit (a.s), Is’haku (a.s), edhe ky jetoi deri në fundin e jetës së tij në Palestinë, në Kuds dhe aty u varros. Gjithashtu, edhe djali i profeti Is’hak, Jakubi (a.s) e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij në Palestinë, bashkë me bijtë e tij, derisa erdhi dita që emigruan edhe një herë tjetër, të gjithë sa ishin, për në Egjipt. Ata emigruan në Egjipt me ftesën e profetit Jusuf (a.s), i cili ishte biri i Jakubit (a.s) dhe me ftesën e mbretit të Egjiptit në atë kohë.

Kështu pra, fillimisht, njeriu i zgjedhur i Allahut, Ibrahim (a.s), që njihet si babai i profetëve dhe Halilu-Rrahman, erdhi si emigrant në Palestinë. Pasardhësit e

tij qëndruan aty vite me radhë, derisa emigruan edhe një herë tjetër të gjithë për në Egjipt.

Kur Ibrahim (a.s) pati ardhur për herë të parë në Palestinë, vendin e gjeti të populluar me banorët e saj autoktonë, ken’anët e të tjerë, të cilët i përmendëm më parë. Edhe kur Jakubi (a.s) emigroi me gjithë bijtë e tij për në Egjipt, Palestina vazhdoi të banohej nga po ai popull i lashtë vendas.

EPOKA E BRONZIT E VONË (1550 - 1200 P.E.S)

Epoka e Bronzit e Vonë (1550 - 1200) solli tkurrjen e pushtetit të Heksosëve dhe hyrjen e Palestinës nën pushtetin absolut të egjiptianëve.

EPOKA E HEKURIT (1200-320 P.E.S)

Me ardhjen e Epokës së Hekurit (1200-320 p.e.s), në fillimet e saj (rreth vitit 1200 p.e.s), Palestina dëshmoi prurje të reja të emigrantëve nga rajone të ndryshme, sidomos migrimet nga “popujt e detit”, që siç duket erdhën nga perëndimi i Azisë edhe nga ishujt e detit Egje (nga Kreta dhe ishujt të tjerë), që u vendosën në jug të Palestinës. Në mbishkrimet arkeologjike është gjetur emri i tyre i gdhendur me shkronjat “b-l-s-t”, sipas të cilit ata u qujtën “Felestinë” dhe vendi u bë i njohur gjithashtu me emrin Felestinë (Palestina).

* * *

Pas shumë vitesh në Egjipt, kjo epokë e re solli të reja jo të këndshme për pasardhësit e Jakubit (a.s).

Jakubi (a.s), njihej ndryshe edhe me emrin “Israil”, që do të thotë “Shërbëtor i Zotit”, dhe pasardhësit e tij njiheshin si “Bijtë e Israilit” (në shqip: Israelit).

Pasi kishin kaluar ditë të mira dikur nën mbrojtjen e Jusufit (a.s), tani në këtë epokë, Bijtë e Israelit po kalonin ditë të vështira. Faraoni që e sundonte Egjiptin në këtë kohë, po i keqtrajtonte ata duke i ngarkuar me punët më të rënda e më të rëndomta. Poshtërimi i tij ndaj tyre kishte shkuar deri në atë pikë sa ua vriste foshnjat meshkuj, ndërsa femrat ua linte të jetonin. – (Kur’ani, El Bekare: 49)

Zoti i plotfuqishëm e zgjodhi nga Bijtë e Israelit, Musain (a.s), si profet. Ai i Madhërishmi e pajisi Musain (a.s) me argumente të fuqishme e mrekulli nga ana e Tij dhe e ngarkoi me misionin e vështirë që t’i shpëtonte Bijtë e Israelit nga thundra e Faraonit mizor, e t’i drejtonte edhe një herë për në Tokën e Shenjtë, në Palestinë.

Provat historike tregojnë se Musai (a.s) i udhëhoqi Bijtë e Israelit në drejtim të Tokës së Shenjtë, në gjysmën e dytë

të shekullit të 13 p.e.s, pra nga fundi i Epokës së Vonë të Bronzit dhe fillimi i Epokës së Hekurit.

Ngjarjet që i ndodhën Musait (a.s) në rrugëtimin e tij për të shpëtuar dhe vënë në vijë Bijtë e Israelit, sqarohen të detajuara në librat që flasin për historitë e profetëve.

Fakt është se për shkak të kokëfortësisë së tyre, Beni Israilët u ndëshkuan nga i Plotfuqishmi, që të sorollaten për dyzet vjet nëpër shkretëtirë, pa ditur se ku erren as ku gdhijnë. – (Kur’ani, El-Maide: 26)

Kur mbaroi afati i caktuar për ndëshkim, Zoti i Madhërishëm ua bëri të mundur Bijve të Israelit të hynin në Palestinë, nën drejtimin e profetit Jushua ibn Nunë (a.s). Kjo ndodhi afërsisht rreth vitit 1190 p.e.s.

Që nga koha kur Ibrahim (a.s) hyri për herë të parë në Palestinë e deri tani, kemi një distancë kohore prej afërsisht 710 vitesh.

Nën udhëheqjen e Jushua ibn Nunë, Bijtë e Israelit zunë vend në pjesën verilindore të Palestinës dhe aty vazhduan të jetojnë rreth dy shekuj. Gjatë kësaj kohe ata përjetuan vështirësi nga pushteti që sundonte në atë kohë atje, por vuajtën edhe për shkak të përçarjeve në vetë mesin e tyre, derisa erdhi koha kur profeti i Allahut, Davudi (a.s) i bashkoi dhe i mbajti të bashkuar nën mbretërimin e tij të drejtë, rreth viteve 1004- 963 p.e.s.

Pas Davudit (a.s), mbretërimin e tij e trashëgoi i biri, profeti Sulejman (a.s) (vitet 963-933 p.e.s), i cili pati një mbretëri siç nuk e kishte patur askush para tij dhe nuk do ta ketë askush pas tij një të tillë, me lejen e Zotit. – (Kur’ani, Sad: 35-40)

Pas tyre, kjo mbretëri u nda në dy pjesë, në Mbretërinë e Israelit (923 - 721 p.e.s) dhe Mbretërinë e Judesë (923 - 586 p.e.s).

Secila nga këto dy mbretëri sundoi një pjesë të kufizuar të tokës së Palestinës.

Mbretëria e Israelit u shkatërrua si rezultat i korrupsionit të madh që përfshiu pushtetarët e saj, ndërsa mbretëria e Judesë, e cila kishte si kryeqytet Kudsën, u shkatërrua për shkak të luftërave të jashtme, sidomos nga luftërat e zhvilluara me Faraonin e Egjiptit, Shishek-un.

Që nga viti 730 p.e.s, Palestina hyri përgjithësisht nën sundimin Asirian të ardhur nga Iraku, deri në 645 p.e.s.

Më pas, sundimin e tyre e trashëguan babilonasit, të cilët e morën pushtetin deri në vitin 539 p.e.s.

Asirianët, babilonasit dhe egjiptianët, zëvendësonin njëri-tjetrin, në pushtetin mbi Palestinën e atëhershme.

Pastaj në vitet 539 - 332 p.e.s, ishin

persët ata që pushtuan dhe sunduan Palestinën.

Pas tyre, Palestina hyri nën sundimin Helen (332- 198 p.e.s), të cilët u ndoqën nga Perandoria Seleucide, e cila zgjati deri në vitin 64 p.e.s.

Gjatë sundimit Helen, rreth vitit 164 p.e.s, jehudët arritën të marrin një lloj autonomie. Më pas, rreth vitit 64- 63 p.e.s, erdhën romakët dhe e morën ata Palestinën nën kontrollin e tyre të plotë, duke ua hequr jehudëve të drejtën e autonomisë.

Pas ndarjes së Perandorisë Romake, në vitin 394 , shtetin Romak në Palestinë e zëvendësoi Perandoria Romake e Lindjes, e cila u quajt ndryshe si “Perandoria Bizantine”, dhe që kishte Kostandinopojën (Stambollin e sotëm) kryeqytet të saj.

Palestina vazhdoi të ishte nën sundimin e perandorisë bizantine derisa aty erdhi Islami, në vitin 636.

Gjatë periudhës së sundimit Romak, rreth viteve 66 - 73 pas lindjes së Isait (a.s), jehudët ndezën një revoltë, por komandanti romak Titus e shoi revoltën e tyre dhe e shkatërroi tempullin jehud.

Pastaj jehudët shpërthyen në revoltë edhe një herë tjetër rreth viteve 132 - 135, që rezultoi me dështim total të jehudëve. Pas shtypjes së kësaj revolte, gjenerali romak, Julius Severus, e pushtoi tërësisht Kudsën (Jeruzalemin) dhe e shkatërroi atë. Perandori romak, Hadrian, ndërtoi një qytet të ri mbi rrënojat e qytetit të vjetër, dhe e quajti “Aeilja Kapitolina” (Aelia Capitolina). Jehudët u ndaluan të hyjnë më pas në qytetin e ri që u ndërtua, për rreth 200 vjet.

Që nga ajo kohë e për tetëmbëdhjetë shekuj në vazhdim më pas, numri i jehudëve vazhdoi të shkonte në rënie, ndërsa ken’anët dhe fiset e tjera vazhduan të qëndrojnë e të jetojnë aty, përkrah njëri-tjetrit.

Në vitin 636, një beteje e madhe u zhvillua mes ushtrisë bizantine dhe ushtrisë islame të drejtuar nga komandanti musliman Halid ibn Velid, i njohur si “Shpata e mprehtë Zotit”. Kjo beteje përfundoi me fitoren e ushtrisë islame. Që nga ky moment, në Palestinë zuri vend Islami, duke i dhënë vendit karakterin e tij arab dhe islam. Në këtë kohë, kalifi musliman, Omer ibn Hattabi, mori çelësat e Kudsit- Jeruzalemit.

Siç vihet re nga rrjedha e ngjarjeve, që nga koha kur u shkatërrua Mbretëria e Judesë, rreth vitit 586 p.e.s, pra më shumë se 25 shekuj më parë, jehudët e humbën pushtetin e tyre si mbretër, zotërues apo prijës, në atë tokë.

Përgatiti: Msc. **Arta Ujkaj**, *teologe*

Mbrëmjen e së enjtes, më 19 korrik 2018, në kuadër të programit javor të derseve në xhamitë e Shkodrës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mbajti dersin e tij javor në xhaminë e Tophanës.

E veçanta e kësaj mbrëmjeje ishte prania në xhami e një grupi besimtarësh misionarë të ardhur nga vende të ndryshme të botës, si: Franca, Mali, Mauritania, Algjeria, etj.

Pas dërsit të tij, Myftiu kërkoi që vizitorët të prezantojnë para xhamatit me disa nga eksperiencat e tyre në Thirrjen e njerëzve në Islam.

Në emër të grupit foli z. Kamil, mësues matematike nga Parisi, i cili shpjegoi se Islami në Francë dhe perëndim është përherë në rritje. Ai solli në vëmendje të besimtarëve shembuj të shumtë të konvertimeve në Islam dhe shtimin e xhamive dhe qendrave islame në Paris, që sot kanë kaluar numrin 500.

Ai theksoi se hapja me njerëzit,

NJË MBRËMJE E BUKUR FETARE NË XHAMINË E TOPHANËS



takimi me ta dhe dialogu, mbeten stacione të rëndësishme në rrugën e thirrjes së tyre në Islam.

Një përshëndetje e veçantë ishte edhe ajo e Abdullahut me prejardhje nga Vietnami, që tashmë është një musliman i përkushtuar dhe student i zellshëm i gjuhës angleze në një prej

universiteteve në Britaninë e Madhe.

Në emër të pranishmëve, Myftiu falënderoi vizitorët dhe theksoi se shembulli i përhapjes në masë i Islamit në perëndim është thirrja më e qartë për shqiptarët që të jenë ambasadorët më të mirë të fesë së All-llahut në Evropë dhe kudo në botë.

NJË GRUP NXËNËSISH VIZITUAN BIBLIOTEKËN E QYTETIT

Paraditën e së mërkurës, më 25 korrik 2018, në kuadër të aktiviteteve verore me nxënës të kurseve tona fetare, u zhvillua një vizitë në bibliotekën e qytetit, të cilët u njohën nga afër me shtëpinë e librit dhe ambientet e saj.

Me këtë rast, nxënësit patën mundësi të vizitojnë disa nga ambientet e shtëpisë së librit, si dhe të mësojnë nga shpjegimet e punonjësës së këtij institucioni, znj. Sidita Halluni.

Gjatë kësaj vizite nxënësit e kurseve fetare të xhamive të Shkodrës përmes pyetjeve të ndryshme morën informacionin e duhur se si funksionon biblioteka e qytetit dhe çfarë shërbimesh ofron për lexuesit në përgjithësi dhe për nxënësit e shkollave në veçanti.

Më pas, nxënësit vizituan edhe xhaminë e Parrucës, ku patën mundësi të dëgjojnë edhe një këshillë nga imami i kësaj xhamie, teologu Naim Drijaj, i cili u foli për rolin e dijes dhe vlerën e kërkimit të saj në Islam, duke theksuar se myslimani e ka obligim kërkimin e diturisë në çdo hap të jetës së tij.

Në fund të aktivitetit, teologu Arben Halluni falënderoi pjesëmarrësit dhe shpërndau certifikatat për xhamitë e përfshira në këtë projekt të larmishëm.




NGRIHET MBULESA E QABES SË MADHNUESHME NË PRAG TË HAXHIT 1439

Mbrëmjen e së dielës, më 29 korrik 2018, që korrespondon me datën 16 Dhul-Kade 1439 h., në Xhaminë e Shenjtë është zhvilluar ngritja tradicionale e mbulesës së Shtëpisë së Lashtë të adhurimit, Qabes së Madhnueshme.

Sipas traditës së krijuar, një pjesë e mbulesës ngrihet në lartësinë 3 metra dhe vishet me një copë të bardhë, që sinjalizon ihramin e haxhilerëve.

Ky veprim bëhet për ta ruajtur mbulesën nga dyndja e madhe e besimtarëve nga mbarë bota dhe për të sinjalizuar ardhjen e muajit të Haxhit dhe fillimit të ritualeve të tij.

Këtë vit, një numër i madh besimtarësh muslimanë nga Shkodra dhe krejt trojet shqiptare do të udhëtojnë pas disa ditësh drejt vendeve të shenjta për kryerjen e



Haxhit 1439.

Në prag të këtij udhëtimi, Myftinia Shkodër nis ditën e nesërme, e hënë, më



30 korrik 2018, trajnimin pesëditor, që do të zhvillohet në xhaminë e Parrucës, sipas programit të afishuar më parë.

NIS TRAJNIMI I HAXHILERËVE SHKODRANË TË KËTJË VITI

Pasdreknë e së hënës, më 30 korrik 2018, në xhaminë e Parrucës nisi trajnimi pesëditor i haxhilerëve shkodranë të këtij viti, si pjesë e aktiviteteve të përvitshme që Myftinia Shkodër organizon në shërbim dhe ndihmë të udhëtarëve drejt vendeve të shenjta për kryerjen e Haxhit.

Fillimisht, haxhilerët i përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili uroi dhe u lut që Haxhi i sivjetshëm të jetë sa më i mbarë dhe i pranuar për të gjithë.

Njëkohësisht, lajmëroi se numri i të regjistruarve shkodranë për kryerjen e Haxhit të sivjetshëm është një numër më i madh se ai i vitit që shkoi, duke theksuar se ky fakt përbën një argument me vlerë për rritjen e vetëdijes islame dhe përkushtimit të besimtarëve muslimanë të këtij qyteti për fenë e tyre.

Myftiu lajmëroi për programin e trajnimit dhe uroi që haxhilerët e rinj të përfitojnë nga këto udhëzime, në mënyrë që të përfetojnë një përvojë të mrekullueshme besimi gjatë ditëve të qëndrimit në Mekë dhe Medine.

Ligjërata e ditës së parë u mbajt nga teologu Ruzhdi Plangaj, imam i xhamisë Kiras. Gjatë udhëzimeve të tij, ai u ndal tek shpjegimi i vlerës së Haxhit dhe madhësitë që i ka dhënë All-llahu i Madhëruar këtij adhurimi që mbledh dhe bashkon mbarë botën islame.



Ai shpjegoi domethënien e termit 'Harem', kufijtë e tij, ritet e Umres, ndalesat e ihramit, lejueshmëritë e tij, llojet e Haxhit, domethënien e 'Haxhit temetuë', etj.

Të pranishmit drejtuan pyetje të ndryshme, që kanë të bëjnë me rregullat e

Umres dhe shfrytëzimit të këtij udhëtimi të begatë.

Me mbarësinë e All-llahut, trajnimi vijon ditën e martë, më 31 korrik 2018, pas namazit të mesditës në xhaminë e Parrucës.

Ditën e xhuma, më 3 gusht 2018, në përfundim të trajnimit pesëditor që Myftinia Shkodër zhvilloi me haxhilerët shkodoranë të këtij viti, u zhvillua edhe ceremonia e shpërndarjes së ihrameve dhe pasaportave me vizat e haxhit për grupin e besimtarëve shkodoranë, që këtë vit do të udhëtojnë drejt vendeve të shenjta për kryerjen e Haxhit.

Më herët, imami i xhamisë së Dërgutit, teologu Ervil Kuçi, theksoi se Haxhi është një prej pesë shtyllave të Islamit, ndërsa udhëtimi drejt vendeve të shenjta për kryerjen e këtij adhurimi është një bekim i madh, që nuk mund të perceptohet pa e shijuar dhe ndërjet gjatë ditëve të Haxhit në vendet e shenjta.

Aktivitetin e përshëndetën edhe Imam Muhamed B. Sytari, Myfti i Zonës Shkodër, H. Edmir Smajlaj, Myfti i Malësisë së Madhe, si dhe studiuesi islam nga Jordania, Dr. Xhemal Saferti.

Në mesazhet e tyre, ligjëruesit vlerësuan numrin e madh të haxhilerëve të sivjetshëm nga Shkodra dhe Malësia e Madhe, si dhe përgjegjësinë e madhe

U ZHVILLUA CEREMONIA E SHPËRNDARJES SË IHrameve



që ka besimtari që i përgjigjet thirrjes së All-llahut të Madhëruar për kryerjen e Haxhit.

Më pas u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së ihrameve, pasaportave me vizën e Haxhit, si dhe broshurat e përgatitura nga Zyra e Haxhit pranë

Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për krejt haxhilerët.

Në një atmosferë plot emocion dhe lutje, të pranishmit uruan njëri-tjetrin dhe tashmë përgatiten për udhëtimin e shumëpritur, pas disa ditësh.

DR. ZEKERIJA BAJRAMI LIGJËROI NË TRIBUNËN KUSHTUAR HAXHILERËVE SHKODRANË

Ditën e shtunë, më 4 gusht 2018, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare për nder të haxhilerëve shkodoranë të këtij viti.

I ftuar nderi në këtë aktivitet ishte thirrësi islam i afirmuar, Hoxha i nderuar nga Shkupi, Dr. Zekerija Bajrami.

Aktivitetin e përshëndeti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili falënderoi Hoxhën e nderuar për praninë e tij në Shkodër, "Shkodrën e minareve të bardha, që nuk e prek bardhësinë e tyre, as mesazhin e shenjtë që ato përcjellin, as lajthitja a pakujdesia e dikujt këtu apo atje...".

Myftiu uroi që haxhilerët e këtij viti të kenë bekim e mbarësi dhe të luten që All-llahu ta ruajë e ta bekojë këtë vend, duke u lutur për mirëqenien dhe ruajtjen e rinisë shqiptare nga haramet dhe shturja.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, i cili falënderoi Myftininë e Shkodrës për këtë organizim, sikurse uroi haxhilerët dhe i dëshiroi atyre mbarësi dhe adhurime të pranuar.

Ai tha se haxhilerët janë mysafirët e All-llahut dhe se, atyre u kërkohet që drejt



vendeve të shenjta të shoqërohen dhe të pajisen me përkushtimin dhe përlulen plot dashuri për Zotin e gjithësisë.

Ndërkohë, Dr. Zekerija Bajrami, gjatë fjalës së tij, u përqendrua tek madhështia e Haxhit dhe vlerat e mëdha që ai ka, sidomos në afrimin e besimtarit me Zotin e gjithësisë dhe përfitimit të mëshirës dhe faljes së Tij.

Ndër të tjera theksoi: "All-llahu dhul-xhelal, haxhilerët i llogarit "dujufurr-Rahman", mysafirë të All-llahut! O Zot! Të jesh mysafir i ministrit, mysafir

i kryeministrit, mysafir i mbretit... po mysafir i All-llahut? Subhanallah! Ky është nder i madh!"

Ai nxiti besimtarët që ta shfrytëzojnë Haxhin si një mundësi e madhe për t'u afruar me frymën e dhikrit, adhurimit dhe dashnisë për All-llahun e Madhëruar.

Nëpërmjet shembujve të jetuar, ndodhive historike dhe argumenteve fetare, Hoxha i nderuar dha mesazhe të qarta dhe gjallëruese për zemrën dhe besimin.

48 HAXHILERË NGA SHKODRA U NISËN PËR TË KRYER HAXHIN E SIVJETSHËM...

Pasdreken e së martës, më 7 gusht 2018, tek xhamia e Parrucës u bë përcjellja e haxhilerëve shkodoranë të këtij viti për në vendet e Shenjta, në Mekë dhe Medinë, të cilët do të bashkohen rrugës me grupin tjetër të haxhilerëve shqiptarë, e më pas të gjithë së bashku do të vazhdojnë "udhëtimin jetës" për të kryer kushtin e pestë të fesë islame, obligimin e Haxhit.

Grupi i haxhilerëve të sivjetshëm shkodoranë përbëhet nga 48 persona, burra e gra, dhe 10 haxhilerë nga Malësia e Madhe, të cilët u përcollën nga familjarët e tyre, të afërm, nga besimtarë të shumtë si dhe nga përfaqësues të Myftinisë Shkodër.

Në oborrin e xhamisë së Parrucës, në prani të besimtarëve të shumtë, familjarëve dhe të afërme, të cilët kishin dalë për të përcjellë e për të uruar vëllezërit dhe motrat e tyre, u bë nisja për në vendin më të mirë dhe më të bekuar të botës, Meka e bekuar dhe Medineja e ndriçuar.

Në fjalën e tij të dhënë në prani të mediave, Myftiu i Shkodrës, Imam



Muhamed Sytari, pasi u lut për mbarësi të haxhilerëve shkodoranë dhe bekim për Shkodrën e mbarë Shqipërinë, ndër të tjera tha: "Kjo turmë besimtarësh, që sot ndodhen këtu, është argumenti më i qartë, se shoqëria shqiptare është shoqëri besimtare dhe jo laike, siç propagandojnë disa njerëz sipas epsheve të tyre".

Ashtu si çdo vit tjetër, Myftinia Shkodër organizoi përcjelljen e

haxhilerëve shkodoranë me autobus drejt aeroportit të Rinasit, ku më pas do të bashkohen me vëllezërit dhe motrat e tjerë haxhilerët shqiptarë, për të vazhduar rrugëtimin drejt Qabes së Madhërueshme, xhamisë më të vjetër në tokë, që është ndërtuar për të adhuruar Zotin e Vetëm dhe të Plotfuqishëm.

Haxh dhe lutje të pranuar për të gjithë haxhilerët, shkodoranë, shqiptarë dhe të mbarë botës islame!

IMAMËT E MYFTINISË SHKODËR TAKIM PUNE NË PRAG TË KURBAN BAJRAMIT 1439/2018

Paraditen e së martës, më 14 gusht 2018, imamët e Myftinisë Shkodër zhvilluan një takim pune në prag të Kurban Bajramit, ku trajtuan disa çështje të ndryshme rreth thirrjes islame dhe aktivitetit të përditshëm të imamit.

Në këtë takim të imamëve, diskutimi u përqendrua te festa e Kurban Bajramit, festa e madhe e muslimanëve, që këtë vit përkon me datën 21 gusht 2018, ditën e martë.

U diskutua programi i Kurban Bajramit, që do të zhvillohet në sheshin e Namazgjasë, bri xhamisë së Fushë Çelës, (xhamia "Ebu Bekër"), duke nisur me faljen e sabahut me xhematë, në orën 05.30, ligjëruesit e kësaj ceremonie, hatibi si dhe pritja tradicionale, që do të zhvillohet në xhaminë e Parrucës, më 21 gusht 2018, nga ora 9-11 paradite.

Në fund imamët u lutën, që haxhilerëve shkodoranë, por edhe të gjithë haxhilerëve të botës, All-llahu tua pranojë Haxhin, lutjet dhe gjithë adhurimet e tyre.



NJË GRUP STUDENTËSH NGA MILANO VIZITUAN XHAMINË E PARRUCËS

Ditën e martë paradite, më 14 gusht 2018, në xhaminë e Parrucës, u zhvilluan një bashkëbisedim i ngrohtë me një grup studentësh katolikë nga qyteti i Milanos, Itali, të cilët shoqëroheshin nga Dom Enzo, prifti i Blinishtit, Lezhë.

Studentë u pritën nga, teologu Lavdrim Hamja, njëkohësisht imam i xhamisë së “Dy Vajzave” dhe teologu Ervil Kuçi, përgjegjës i rinisë pranë Myftinisë Shkodër.

Fillimisht teologu Hamja i uroi mirëseardhjen studentëve dhe i njohu shkurtimisht me aktivitetin e Myftinisë Shkodër dhe kontributin e saj në ruajtjen e harmonisë, paqes dhe bashkëjetesës komunitare mes tre besimeve tradicionale në qytetin e Shkodrës.

Më pas teologu Hamja bëri një paraqitje të përgjithshme të shtyllave të besimit dhe të fesë në Islam, pasi edhe qëllimi i vizitës së këtij grupi studentor ishte njohja me Islamin dhe parimet e tij. Ndër të tjera, ai theksoi se Islami ka



në thelb dhe në parim besimin në një Zot të Vetëm, besimin në të gjithë Profetët e Zotit, Librat e Shenjtë dhe parime të tjera, që edhe ato gjenden tek fetë e tjera monoteiste.

Studentë patën mundësi të bëjnë pyetje të ndryshme rreth Islamin, myslimanëve dhe bashkëjetesës fetare në Shkodër dhe në Shqipëri dhe të njihen me ritet islame, që kryhen prej myslimanëve,

si namazi, agjërimi, haxhi etj.

Në fund, të dy teologët, Hamja dhe Kuçi falënderuan drejtuesin e këtij grupi, Dom Enzo dhe studentët për vizitën e tyre në xhamitë e Shkodrës, shprehën kënaqësinë e tyre për këtë takimi të ngrohtë dhe të dobishëm dhe njëkohësisht u thanë mysafirëve, se janë të mirëpritur kurdoherë në Myftininë e Shkodrës dhe në xhamitë e saj.

TRAGJEDIA E GJENOVËS, IMAMI NË FUNERALIN E VIKTIMAVE: ÇDO URË QË BIE KRIJON DHIMBJE!

(Ceremoni myslimane në funeralin e dy shqiptarëve në mesin e viktimave të Gjenovës)

Gjenova, 18 Gusht 2018

Po shpërndaj këtë reflektim ngushëllues dhe këtë lutje të sinqertë të imamit Dr. Muhammed Dachan, president i nderit i UCOII, në homazhet e bëra nga shteti italian në panairin e Gjenovës, për të përkujtuar dy nënshtetas shqiptarë me përkatësi fetare islame dhe të gjitha viktimat e rëna me rastin e shembjes së urës “Morandi”.

“Shembja e një ure qoftë ajo në formë fizike apo metaforike provokon gjithmonë dhimbje dhe shënon një humbje të rëndë për të gjithë njerëzimin.

Dhimbja është e pafund dhe ne ia besojmë Zotit lutjet tona për të gjitha viktimat, familjet e tyre, të plagosurit dhe të dëshpëruarit, por edhe për të gjithë ata që dhanë ndihmën e parë. Lutjet tona shkojnë edhe për të gjithë ata që kanë celebruar funeralet në mënyrë private.

Jemi afër të gjithë juve dhe kërkojmë prej Zotit, në Atë të Cilin mëshira e Tij e pafundme na ka mësuar vlerën e urave, me urën e parë simbolike me të cilën ka bashkuar midis mashkullit të parë



dhe femrës së parë, duke krijuar kështu bashkimin e të gjithë njerëzimit për të na bërë të vetëdijshëm për përgjegjësitë tona, kërkojmë nga Ai që të mirëpresë të gjithë shpirtat e viktimave dhe të ngushëllojë familjarët e tyre.

Lutemi për Gjenoven: Do të dijë të ringrihet sërish me krenari, Gjenova jonë, e cila në gjuhën arabe do të thotë: “E bukura” dhe që është në zemrat tona.

Komunitetet islame të Gjenovës, të Ligurias dhe të Italisë në tërësi luten derisa paqja të jetë mbi të gjithë ju. Zoti e ruajt Italinë dhe italianët”.

(www.askanews.it)

(www.facebook.com/nader.akkad)

Përktheu nga italishtja dhe përshtati në shqip:

Ervil Kuçi

KREMTOHET ME MADHËSHTI KURBAN BAJRAMI 1439



Ditën e martë në mëngjes herët, më 21 gusht 2018, myslimanët shkodranë u mbledhën në sheshin e vakëfit të Fushë Çelës, bri xhamisë “Ebu Bekër”, ku Myftinia Shkodër tashmë e ka bërë traditë të kryejë ritualet e Kurban Bajramit.

Në këtë ditë të bekuar, organizohet një program i pasur me ligjërata të larmishme, ku besimtarët e shumtë të pranishëm, pasi falin së bashku namazin e sabahut, kanë mundësi të dëgjojnë prej imamëve dhe teologëve të Shkodrës. Programi i kësaj dite filloi me faljen e namazit të sabahut, i cili i drejtuar nga teologu Ervil Kuçi, imam i xhamisë së Dërgutit dhe pastaj vazhdoi me ligjëratat e mbajtura nga imamët e nderuar: Naim Driaj – imam i xhamisë së Parrucës, Ruzhdi Plangaj – imam i xhamisë së Kirasit, Arben Halluni, përgjegjës i Arsimit pranë Myftinisë Shkodër dhe Lavdrim Hamja – imam i xhamisë së “Dy Vajzave”.

Përmes ligjërata të vlefshme, imamët e nderuar përcollën mesazhe të mrekullueshme rreth vlerave të besimit, Islamit, moralit, përkushtimit dhe zbatimit të drejtë të fesë në

jetën e përditshme të besimtarit. Ata theksuan, se është shumë e nevojshme, që myslimani të zbatojë me rigorozitet parimet dhe mësimet islame, të cilat janë transmetuar nga i Dërguari i Allahut, Muhammedi (a.s).

Falja e namazit të Kurban Bajramit u drejtua nga imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja,

ndërkohë hytbeja e Kurban Bajramit u mbajt nga imami i xhamisë së Parrucës, teologu Durim Kasemi.

Në fund, besimtarët e shumtë, që morën pjesë në këtë festë të bekuar, uruan njëri-tjetrin, duke lutur Zotin (xh. sh) për mirësi e begati, në dynja dhe në ahiret.

VIZITORË TË SHUMTË UROJNË KURBAN BAJRAMIN

Pas përfundimit të ceremonisë së faljes së Kurban Bajramit, ditën e parë të tij, të martën më 21 gusht 2018, si zakonisht për çdo vit, Myftinia Shkodër ka organizuar pritjen tradicionale të miqve dhe vizitorëve, të cilët vijnë për të uruar këtë ditë të madhe dhe të begatë, për mbarë myslimanët.

Një përfaqësi e përbërë nga imamët dhe këshilltarët të Myftinisë Shkodër, në mungesë të Myftiut, Imam Muhamed Sytari, i cili edhe këtë vit ndodhet në Haxh, kanë pritur me këtë rast në xhaminë e Parrucës, miq dhe vizitorë, duke nisur nga drejtuesit më të lartë të institucioneve fetare të Shkodrës, drejtues të institucioneve vendore e lokale, deputetë, intelektualë dhe besimtarë të shumtë.

Tashmë pritjet tradicionale, të cilat organizohen me rastin e festave fetare, nxjerrin në pah vlerat e harmonisë fetare të Shkodrës, që me të vërtetë është një gjurmë e çmuar e traditës së respektimit të fesë së tjetrit.

Myftinia Shkodër, e cila gjithmonë ka promovuar vlera të larta të harmonisë, solidaritetit dhe vëllazërisë, lutet që Shkodra dhe qytetarët e saj të kenë bekimet dhe mirësitë e Zotit të gjithësisht në jetën e tyre.



MYFTINIA SHKODËR SHPËRNDAN PAKO ME MISH KURBANI PËR INVALIDË



Ditën e dytë të Kurban Bajramit, më 22 gusht 2018, Myftinia Shkodër me rastin e festës së begatë të Kurban Bajramit bëri shpërndarjen e 30 pakove me mish kurbani për personat me aftësi ndryshe.

Kjo gjë u arrit falë mirësisë dhe bashkëpunimit të institucioneve partnere të ndryshme, të cilat kontribuojnë herë pas here me ndihma humanitare për shtresat në nevojë.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni uroi festën e Kurban Bajramit kësaj shtrese të veçantë të shoqërisë sonë dhe theksoi se institucioni i Myftinisë Shkodër ka

gjithmonë në vëmendje njerëzit në nevojë, sidomos me rastin e festave islame.

Kryetari i shoqatës së invalidëve Para & Tetrapelgjikë, z. Saimir Beqiri ndër të tjera tha, se kjo nisëm erdhi falë bashkëpunimit të frytshëm me Myftininë Shkodër dhe shprehu falënderimet e përzemërta për këtë kontribut të dhënë, në ndihmë të këtyre personave. Gjejmë rastin t'ju urojmë gjithë besimtarëve myslimanë, gëzuar dhe për shumë vjet festen e Kurban Bajramit. Urojmë sa më shumë mirësi, tolerancë dhe solidaritet mes njëri-tjetrit.



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

“Çdo njeri

do të qëndrojë

nën hijen

e sadekasë së tij,

derisa të kryejë

gjykimi i njerëzve

(në ditën

e gjykimit)!”

(Ahmedi dhe Hakimi)

MEDIA TURKE: NJIHUNI ME HERONJ MUSLIMANË QË SHPËTUAN HEBRENJ NGA TERRORI NAZIST


Jo vetëm Shqipëria e trajton si virtyt të saj shpëtimin e hebrenjve përgjatë Luftës së Dytë Botërore, por dhe Turqia. Në këtë pikë, ndryshe nga narrativa zyrtare shqiptare, Turqia i mëshon jo aq nacionalitetit në treguesit humanë, se sa besimit fetar.

Ajo evidenton tre figura si simbol të shpëtimit të hebrenjve, duke i konsideruar ata si “tre muslimanë”, të cilët njëherësh ishin tre diplomatë të kohës që lanë gjurmë me aktet e tyre kurajoze.

I pari është Behiç Erkin, i cili shërbeu si ambasador turk në Francë nën pushtimin gjerman pas qershorit të vitit 1940. Erkin e përdori pozitën e tij për të dhënë dokumentacionin turk për çdo hebre që mund të tregonte edhe lidhjen me të dobët me Turqinë, e më vonë organizonte evakuimin e tyre në Turqi duke i shpëtuar kështu ata nga persekutimi nazist.

Tjetri është Selahattin Ülkümen, një konsull turk në ishullin e Rodosit, që shërbeu në korrik të vitit 1944 kur gjermanët filluan të dëbonin 1,700 hebrenj, disa prej të cilëve ishin qytetarë turq. Ülkümen reagoi ndaj Gestapos duke deklaruar: “sipas ligjit turk të gjithë qytetarët ishin të barabartë, ne nuk bënim dallime mes qytetarëve që ishin hebrenj, të krishterë apo muslimanë”.

Ai arriti të shpëtojë 50 hebrenj, 13 prej tyre qytetarë turq. Në shenjë hakmarrjeje, Gjermania bombardoi konsullatën në Rodos, duke vrarë gruan e tij dhe e deportoi diplomatit në Greqi, ku qëndroi në paraburgim për pjesën tjetër të luftës.



Pas tyre vjen Necdet Kent, gjeneral konsull turk në Marsejë, gjatë viteve 1941-1944. Në vitin 1943, Kent u lajmërua nga një punëtor i konsullatës që 80 hebrenj turq ishin ngarkuar në një tren që do t'i çonte drejt Gjermanisë. Ai nxitoi drejt stacionit të Shën Karlosit, ku gjeti në vagonët e destinuar për bagëti me qindra hebrenj që qanin.

Kur komandanti i Gestapos nuk pranoi kundërshtimin i Kentit se këta njerëz, si qytetarë turq, nuk mund të marreshin, ai hipi në tren vetë sapo u ai u nis. Në stacionin tjetër, zyrtarët gjermanë, të tronditur nga veprimi i Kentit, u detyruar t'i zbresin të gjithë hebrenjtë duke i lënë ata që të udhëtojnë drejt Stambollit.

Ndërkaq, media turke që u ka kushtuar një shkrim heronjve të saj në shpëtimin e hebrenjve, veçon dhe të tjera raste jo turke, por gjithashtu muslimane, duke përzgjedhur dhe një

prej shumë rasteve shqiptare.

Një diplomat iranian, Abdol Hossein Sardari, gjithashtu përdorte zyrën e tij për të shpëtuar hebrenjtë në Paris, ku ai shërbeu në zyrën konsullore iraniane. Në vitin 1942, pas nisjes së projekteve të tmerrshme të nazistëve, Sardari filloi lëshimin e qindra pasaportave iraniane për hebrenj jo-iranianë, duke u dhënë atyre një shans që të shpëtonin nga persekutimi. Për të siguruar qëndrueshmërinë e planit të tij, Sardari veçoi fshehurazi pa leje. Megjithatë, veprimet e tij u përshëndetën më vonë nga qeveria iraniane.

Khaled Abdul Wahab, një burrë i ri tunizian, strehoi 25 hebrenje tunizianë në fermën e familjes së tij pasi dëgjoi se oficerët gjermanë nazistë po planifikonin të përdhunonin një grua hebreje. Ata u fshehën në mënyrë të sigurt në familjen dhe pronat e tij deri në fund të pushtimit në prill 1943.

Një grup tjetër i heronjve muslimanë ishte familja Pilku në Shqipëri, e cila strehoi Johanna Neumann-in dhe nënën e saj në shtëpinë e tyre, duke bindur të tjerët se gratë ishin të afërm të vizituar nga Gjermania.

“Ata vunë jetën e tyre në rrezik për të na shpëtuar”, tha 86-vjeçarja Neumann për israeliten TIME në janar.

“Çfarë bënë këta njerëz, shumë kombe evropiane nuk e bënë. Të gjithë vendosën të shpëtonin hebrenjtë”, tha ajo.

(www.tesheshi.com)



MYFTINIA SHKODËR JU URON:
GËZUAR KURBAN BAJRAMIN!

Haxh - 2018



**HAXH TË PRANUAR HAXHILERËVE TË SHKODRËS,
TË SHQIPËRISË DHE TË MBARË YMETIT ISLAM!**

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

**“Haxhi i pranuar
nuk ka shpërblim tjetër,
veçse xhenetin!”**

(Transmetuar nga Buhariu dhe Muslim)



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org